

## 4 KUADRI RREGULLATIV DHE METODOLOGJIK, DHE PROCESI I LICENCIMIT

### 4.1 KUADRI RREGULLATIV DHE METODOLOGJIK

Hartimi i akteve të reja nënligjore dhe rishikimi i kuadrit rregullativ në fuqi synon plotësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tij, në funksion të realizimit të një mbikëqyrjeje më efektive dhe në zbatim të kërkesave ligjore për bankat dhe subjektet e tjera të licencuara e mbikëqyrura nga Banka e Shqipërisë, nëpërmjet përafrimit me aktet rregullative të Bashkimit Evropian, si dhe me parimet bazë për mbikëqyrjen efektive dhe dokumentet e Komitetit të Bazelit.

Gjatë vitit 2019, vëmendje e veçantë iu dedikua hartimit të akteve të reja rregullative dhe rishikimit të atyre në fuqi, në zbatim të angazhimit të Bankës së Shqipërisë, kryesisht për zbatimin e rekomandimeve të Komitetit të ekspertëve të Moneyval për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, për përafrimin e kuadrit rregullativ me kërkesat e Bazel III, si dhe për reduktimin e kredive me probleme.

Aktet e reja rregullative të miratuara, si dhe ato të rishikuara gjatë vitit 2019, renditen në vijim.

- **Miratimi i ndryshimeve në rregulloren “Për kapitalin rregullator të bankës” (miratuar me vendimin nr. 2, datë 9.1.2019, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë).**

Qëllimi i këtyre ndryshimeve rregullative synoi të përafrojë më tej kërkesat e Bankës së Shqipërisë me kërkesat e Bazel III, me qëllim rishikimin e raporteve të parashikuara në këtë rregullore, përkatësisht të nivelit të raportit minimal të kapitalit bazë të nivelit të parë ndaj ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, nga 4.5% në 6.75% dhe të nivelit të raportit minimal të kapitalit të nivelit të parë ndaj ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, nga 6% në 9%, duke i përshtatur këto raporte në mënyrë përpjesëtimore me nivelin minimal të kërkuar të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 12%.

- **Miratimi i rregullores së re “Për raportin e mbulimit me likuiditet” (miratuar me vendimin nr. 27, datë 28.3.2019, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë).**

Hartimi i rregullores “Për raportin e mbulimit me likuiditet” vjen në kuadër të përafrimit të mëtejshëm të kërkesave të Bankës së Shqipërisë me kërkesat e Komitetit të Bazelit dhe të rregulloreve evropiane për administrimin e rrezikut



të likuiditetit, në përmbushje të objektivave strategjike të Departamentit të Mbikëqyrjes për implementimin e kërkesave të Bazel III. Kjo rregullore përcakton kriteret dhe rregullat për llogaritjen e raportit të mbulimit me likuiditet (RML) dhe kërkesat e autoritetit mbikëqyrës për nivelin minimal të këtij raporti (në total për të gjitha monedhat dhe për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme).

Ky akt i ri rregullativ synon të plotësojë kuadrin rregullativ në fuqi për administrimin e rrezikut të likuiditetit, nëpërmjet prezantimit të raportit të mbulimit me likuiditet (RML) si një tregues i ri dhe duke përcaktuar kërkesat për bankat për krijimin e një rezerve likuiditeti, e cila në kushte të stresit të likuiditetit do të arrijë të mbulojë flukset dalëse neto, brenda një horizonti kohor prej 30 ditësh kalendarike. Rregullorja paraqet elementet përbërëse të treguesit të RML-së, si dhe kriteret e përshtatshmërisë që duhet të plotësojnë këto elemente, për t'u klasifikuar si aktive likuide, flukse dalëse apo flukse hyrëse të likuiditetit. Raporti i mbulimit me likuiditet, është një tregues dinamik, në dallim nga treguesi aktual i likuiditetit, i cili synon të jetë statik.

Rregullorja parashikon kërkesa mbikëqyrëse për llogaritjen e RML-së mbi baza individuale dhe të konsoliduara; kërkesa të përgjithshme, kërkesa operacionale dhe kriteret të pranueshmërisë që duhet të përmbushin aktivet likuide, në mënyrë që të klasifikohen për t'u përfshirë në rezervën e likuiditetit, si dhe kërkesa për vlerësimin e aktiveve likuide nëpërmjet vlerës së tregut; përcaktimin e përbërjes së rezervës së likuiditetit sipas nivelit të aktiveve, duke caktuar edhe kufij (minimalë apo maksimalë) për secilin nivel dhe parashikimin e *haircut*-eve të zbatueshme për secilin nivel të aktiveve likuide (përkatësisht për aktivet e nivelit 1, nivelit 2A dhe nivelit 2B); metodologjinë e përlllogaritjes së flukseve dalëse të likuiditetit dhe kriteret për klasifikimin e zërave të bilancit apo jashtë bilancit, në kategorinë e flukseve dalëse që lidhen me depozitat e qëndrueshme dhe depozita të tjera me pakicë, me depozitat operacionale, si dhe të flukseve dalëse që rrjedhin nga lehtësirat e likuiditetit dhe të kredisë dhe nga produkte, shërbime apo detyrime të tjera; parashikimin e normave që bankat duhet të zbatojnë për secilën prej kategorive të flukseve dalëse; kërkesa për flukset hyrëse të likuiditetit dhe normat e zbatueshme për përlllogaritjen e tyre; përcaktimin e një *cap*i për flukset hyrëse; si dhe kërkesa raportuese dhe monitoruese. Rregullorja ka hyrë në fuqi në datë 1 mars 2020.

- **Miratimi i disa ndryshimeve në rregulloret e mëposhtme, në zbatim të plotësimin të Rekomandimeve të ekspertëve të Moneyval për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, gjatë vlerësimit të Raundit V për Shqipërinë, miratuar përkatësisht me vendimet nr. 46, 47, 48, 49 dhe 50, të datës 3.7.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë):**
  - Rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”;
  - Rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”;
  - Rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive



- të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”;
- Rregulloren “Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor”; si dhe
- Rregulloren “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka”

Ndryshimet në rregulloret e licencimit trajtojnë kryesisht kërkesa shtesë të Bankës së Shqipërisë për subjektet aplikuese, gjatë procesit të licencimit (bankave, subjekteve financiare jobanka, shoqërive të kursim-kreditit dhe unioneve të tyre dhe zyrave të këmbimit valutor). Këto kërkesa lidhen me integritetin e aksionerëve/ortakëve (duke përfshirë edhe aksionerët/ortakët indirektë dhe përfituesit e fundit), duke e zgjeruar fokusin edhe tek personat e lidhur me aksionerët/ortakët, nëse kanë rekorde kriminale. Bazuar në këto kërkesa, subjektet duhet të kryejnë procesin e rivlerësimit në vazhdimësi të integritetit të aksionerëve/ortakëve dhe raportimin e rezultateve një herë në vit në Bankën e Shqipërisë dhe sa herë ka ndryshime të kushteve mbi të cilat është dhënë licenca dhe miratimet paraprake. Këto ndryshime parashikojnë edhe disa raste kur Banka e Shqipërisë mund të refuzojë dhënien e licencës, kryesisht, nëse subjekti që kërkon të licencohet mund të cenojë interesat e publikut ose nëse aksioneri/ortaku i subjektit të propozuar paraqet rrezik të lartë, është një bankë guaskë, zotëron aksione të mbajtësit (*bearer shares*), është aksioner përfaqësues (*nominee shareholder*), ose ka një strukturë komplekse pronësie.

Ndryshimet në rregulloret e licencimit **për të gjitha subjektet** përfshijnë, ndër të tjera, kërkesa për dokumentacion dhe informacion të detajuar kryesisht: i) për pjesëmarrjet e tërthorta në kapitalin e bankës deri në përfituesit e fundit (individë), që do të zotërojnë një vlerë jo më të vogël se 5% në kapitalin e bankës; ii) për lidhje të mundshme (personale, pune apo biznesi) të aksionerëve/ortakëve të subjekteve me persona që janë dënuar për kryerjen e veprave penale; iii) për rastet kur banka kërkon të zgjerojë rrjetin e saj brenda Republikës së Shqipërisë dhe jashtë Republikës së Shqipërisë lidhur me rreziqet, sistemet e kontrollit, etj.; iv) për rastet e riorganizimeve juridike të subjekteve lidhur me mjaftueshmërinë e sistemit të administrimit të rreziqeve, përfshirë edhe rrezikun e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, etj.

Në veçanti, **ndryshimet në rregulloren e licencimit të subjekteve financiare jobanka**, parashikojnë: i) shtimin e kriterëve të emërimit për anëtarët e këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratorin dhe anëtarët e komitetit të kontrollit të subjekteve, si dhe të dokumentacionit që duhet të paraqitet pranë Bankës së Shqipërisë, për marrjen e miratimit paraprak për kryetarin e këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratorin/ët dhe kryetarin e komitetit të kontrollit, pasi kriteret e mëparshme rregullative parashikonin kërkesa vetëm për administratorin; dhe ii) detyrimin e krijimit të komiteteve të specializuara në nivel këshilli administrimi/mbikëqyrës të tilla si komiteti i kontrollit, rrezikut/qeve, etj.), të cilat këshillojnë/asistojnë këshillin për çështje të veçanta, duke konsideruar parimin e proporcionalitetit bazuar në natyrën, madhësinë, kompleksitetin e veprimtarisë dhe profilin e rrezikut të subjektit).



Po kështu, **ndryshimet në rregulloren e licencimit të zyrave të këmbimit valutor parashikojnë:** i) rritjen e nivelit të kapitalit fillestar minimal të kërkuar, për subjektet që do të aplikojnë për licencim pas hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve rregullative, respektivisht nga 1.5 milionë lekë që parashikohet në kriteret e mëparshme rregullative, në 2.5 milionë lekë, ii) shtimin e kriterit të zotërimit të një diplome universitare, për administratorin e subjektit, iii) shtimin e kërkesave raportuese lidhur me dokumentacionin që duhet të riparaqesin zyrat në Bankën e Shqipërisë (pas licencimit), mbi baza vjetore, të tilla si vërtetimet për integritetin e aksionerit/ortakut/administratorit dhe për lidhje të mundshme të tyre me persona të dënuar për kryerjen e veprave penale, por edhe të dhëna financiare mbi ecurinë e veprimtarisë së subjektit gjatë vitit të fundit dhe për shlyerjen e rregullt të detyrimeve fiskale.

Ndërkohë, **ndryshimet në rregulloren “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka”** konsistojnë në parashikimin e kërkesave për funksionin/njësine e kontrollit të brendshëm dhe për funksionin e përputhshmërisë, si njësi të pavarura dhe pjesë të rëndësishme të sistemit të kontrollit, si dhe të përgjegjësive dhe detyrave të këtyre funksioneve.

Në vazhdimësi të ndryshimeve rregullative të miratuara në korrik 2019, sërisht në kuadër të plotësimit të rekomandimeve të ekspertëve për Raundin V të vlerësimit të Shqipërisë nga Komiteti Moneyval, bazuar edhe në standardet e FATF<sup>2</sup>, si dhe në përputhje me dispozitat e rishikuara të ligjit të posaçëm “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, në dhjetor 2019, u miratuan edhe disa ndryshime në tre rregulloret e mëposhtme.

- **Miratimi i disa ndryshimeve në rregulloret e mëposhtme (miratuar përkatësisht me vendimet nr. 78, 79, dhe 80, të datës 18.12.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë):**
- Rregulloren “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”;
- Rregulloren “Për mbikëqyrjen e konsoliduar”;
- Rregulloren “Për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike”.

Më konkretisht, ndryshimet në rregulloren “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, konsistojnë në forcimin e mëtejshëm të kërkesave të autoritetit mbikëqyrës për subjektet, në drejtim të një administrimi më të mirë të rrezikut të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, në nivel individual dhe në nivel grupi. Njëkohësisht, pjesë e ndryshimeve rregullative janë edhe disa kërkesa më të shtrënguara për integritetin e punonjësve të subjekteve, si dhe kërkesa për trajnimin e vazhdueshëm të personave përgjegjës dhe të strukturës përgjegjëse për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Në rrjedhë logjike me ndryshimet në rregulloren e parandalimit të pastrimit të parave për zbatimin e vigjilencës së zgjeruar ndaj klientëve, për të cilën kërkohet

<sup>2</sup> Financial Action Task Force.



prania fizike e klientëve dhe e përfaqësuesve të tyre, para se të vendoset çdo lloj marrëdhënieje biznesi, u shfuqizua dispozita në rregulloren “Për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike”, mbi praninë fizike të klientëve dhe të përfaqësuesve të tyre për hapjen e llogarive *e-banking*, pasi kjo kërkesë është e rregulluar tashmë në rregulloren e sipërcituar, për çdo marrëdhënie biznesi, përfshirë edhe hapjen e llogarive *e-banking*. Ndërkohë, ndryshimet e rregullores “Për mbikëqyrjen e konsoliduar”, synojnë të forcojnë kërkesat për subjektet e grupeve bankare/financiare, të cilat janë subjekt i mbikëqyrjes së konsoliduar të Bankës së Shqipërisë, në drejtim të hartimit të programeve në nivel grupi nga ana e institucionit mbizotërues, për një administrim më të mirë të rrezikut të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit.

- **Miratimi i rregullores së re “Për trajtimin jashtëgjyqësor nga bankat, të kredimarrësve në vështirësi financiare” (miratuar me vendimin nr. 51, datë 3.7.2019, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë).**

Rregullorja “Për trajtimin jashtëgjyqësor nga bankat, të kredimarrësve në vështirësi financiare”, e quajtur ndryshe “*Tirana Approach*”, u hartua me asistencën e ekspertëve të Bankës Botërore (projekti FinSAC) dhe synon përmbushjen konkrete të detyrimeve të Bankës së Shqipërisë në kuadër të Planit Kombëtar për Adresimin e Kredive me Probleme, si edhe plotësimin e masave të vazhdueshme, të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë për adresimin e kredive me probleme në vend.

Rregullorja synon të nxisë trajtimin e kredimarrësve në vështirësi financiare, nëpërmjet një bashkëpunimi të strukturuar dhe eficient ndërmjet bankave, duke siguruar mundësinë e një platforme bashkëpunimi, ku bankat koordinojnë përpjekjet dhe gjejnë zgjidhje që reflektojnë natyrën e vështirësisë së huamarrësit dhe i krijojnë atij lehtësira për gjenerimin e likuiditeteve, për vazhdimin dhe rimëkëmbjen e veprimtarisë dhe për shlyerjen e detyrimeve ndaj bankave. Nga ana tjetër, zgjidhjet mbajnë në konsideratë edhe nivelin e ekspozimit dhe pozicionin e secilës prej bankave ndaj huamarrësit. Rregullorja parashikon, ndër të tjera, kërkesën për nënshkrimin e një marrëveshjeje që rregullon mënyrën e koordinimit të tyre (bankave) me njëra-tjetrën, proceset që duhet të ndiqen dhe mënyrën e vendimmarrjes mbi zgjidhjet e identifikuar. Gjithashtu, rregullorja parashikon edhe një projekt marrëveshjeje për t’u nënshkruar nga të gjitha bankat me huamarrësin dhe rregullon përgjegjësitë dhe detyrimet përkatëse gjatë periudhës së moratoriumit, periudhë gjatë së cilës bankat ndërpresin ose nuk ndërmarrin iniciativë ligjore ndaj huamarrësit, ku analizojnë situatën financiare të tij dhe identifikojnë zgjidhjet e përshtatshme, pa rënë ndesh me detyrimet kontraktuale ekzistuese që janë nënshkruar individualisht nga secila bankë me huamarrësin.

Rregullorja përcakton gjithashtu edhe disa kritere për huamarrësit, që do të mund të përfshiheshin në marrëveshjen mes bankave, ndërkohë që nuk përjashton mundësinë e trajtimit në kuadër të kësaj rregulloreje, edhe të ekspozimeve që mbeten jashtë këtyre përcaktimeve.



Kjo rregullore është parashikuar të mbetet në fuqi deri në dhjetor 2020, me qëllim që t'i nxitë bankat të ndërmarrin të gjitha iniciativat e mundshme për të adresuar kredimarrësit e përbashkët në një kohë sa më të shkurtër.

- **Miratimi i disa ndryshimeve në rregulloren “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja” (miratuar me vendimin nr. 52, datë 3.7.2019, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë)**

Ndryshimet në këtë rregullore janë në të njëjtën linjë me rregulloren e re “Për trajtimin jashtëgjyqësor nga bankat, të kredimarrësve në vështirësi financiare”. Këto ndryshime rregullative synojnë forcimin e kritereve të klasifikimit dhe provigjionimit të kredive të ristrukturuara, por do të hyjnë në fuqi më 1 janar 2021, periudhë që përkon edhe me shfuqizimin e rregullores së trajtimit jashtëgjyqësor të huamarrësve. Në këtë mënyrë, bankave iu jepet mundësia të shfrytëzojnë lehtësinë rregullative ekzistuese për ristrukturimin e huamarrësve, deri në dhjetor 2020. Gjithashtu, nëpërmjet ndryshimeve rregullative u reduktua afati i fshirjes së kredive të humbura nga bankat, nga 3 vjet në 2 vjet, me qëllim uljen e mëtejshme të kredive me probleme në sistem.

- **Miratimi i udhëzimit të ri “Për stress test-et e bankave” (miratuar me vendimin nr. 60, datë 4.9.2019, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë)**

Udhëzimi i ri përafroon udhëzuesin e EBA-s<sup>3</sup>, mbi përgatitjen e *stress testeve* nga bankat, në përputhje me kërkesat e Bazel III për administrimin e rreziqeve. Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e kërkesave dhe metodologjive mbi kryerjen e *stress testeve* nga bankat, si pjesë e procesit të tyre të administrimit të rreziqeve, veçanërisht në kuadër të procesit të vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit.

Megjithëse kuadri rregullativ në fuqi i Bankës së Shqipërisë, parashikon kërkesa për kryerjen e *stress testeve* nga bankat për disa lloje të caktuara rreziqesh<sup>4</sup>, hartimi i këtij projektudhëzimi të veçantë, synoi unifikimin e praktikave që bankat duhet të ndjekin për kryerjen e *stress testeve*, duke trajtuar në mënyrë më të detajuar lloje të ndryshme të *stress testeve*, sipas kompleksitetit apo llojeve të rreziqeve me të cilat bankat ndeshen gjatë veprimtarisë së tyre. Udhëzimi parashikon kërkesa të detajuara mbi programin e *stress testeve*; aspekte të drejtimit të *stress testeve*, infrastrukturën e agregimit të të dhënave, si dhe procesin e raportimit brenda bankës, për qëllime të *stress testeve*; përcaktimin e rolit dhe përgjegjësisë të organeve drejtuese të bankës në hartimin dhe miratimin e programit të *stress testeve*, por edhe në identifikimin e veprimeve apo masave që duhet të ndërmerren, bazuar në rezultatet e *stress testeve*; qëllimin dhe fushën e zbatimit të *stress testeve*, si dhe llojet e ndryshme të tyre

<sup>3</sup> EBA/GL/2018/04 “Guidelines on institutions stress testing”.

<sup>4</sup> Për shembull për rrezikun e kredisë, rrezikun e likuiditetit, rrezikun e normave të interesit në librin e bankës, etj.



(*stress testeve*); kërkesa për kryerjen e *stress testeve* nga bankat, sipas llojeve të rreziqeve individuale dhe frekuencën e kryerjes së *stress testeve*; kërkesa për raportimin nga bankat, të rezultateve të *stress testeve*, të shoqëruar edhe me masat e ndërmarra nga organet drejtuese të bankës, në përgjigje të këtyre rezultateve, etj.

Ky udhëzim ka hyrë në fuqi në datë 1 mars 2020.

Gjithashtu, gjatë vitit 2019 u punua për **hartimin apo rishikimin e disa akteve rregullative, me rëndësi për mbikëqyrjen bankare dhe për bankat, të cilat pritet të miratohen gjatë vitit 2020**. Në mënyrë më të detajuar, u realizua hartimi apo rishikimi i akteve rregullative si vijon:

- hartimi i rregullores së re “Për përcaktimin e kushteve për dhënien e miratimit paraprak për marrëveshjen e mbështetjes financiare brenda grupit bankar”, e cila ka si objekt të saj përcaktimin e kushteve për dhënien e miratimit paraprak për marrëveshjen e mbështetjes financiare, e cila mund të ofrohet vetëm nga bankat brenda grupit bankar, që është pjesë e mbikëqyrjes së konsoliduar të Bankës së Shqipërisë, si dhe të kërkesave për dokumentacionin dhe përmbajtjen e tij, me qëllim marrjen e këtij miratimi nga Banka e Shqipërisë;
- përgatitja e disa projektndryshimeve në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, që synojnë përafrimin e mëtejshëm me kërkesat e Rregullores Evropiane (CRR) 575/2013/EU “Mbi kërkesat prudenciale për institucionet e kreditit dhe shoqëritë e investimit”, në drejtim të prezantimit të metodës së bazuar në vlerësimin e cilësisë së kredisë së vetë kundërpartisë, për përcaktimin e peshave të rrezikut të kredisë për disa ekspozime (ndaj institucioneve të mbikëqyrura, subjekteve të sektorit publik dhe obligacioneve të garantuara). Gjithashtu, disa ndryshime në këtë rregullore u hartuan bazuar edhe në nevojat për rishikim, të identifikuar nga zbatimi në praktikë i rregullores së sipërcituar apo nga problematikat e ndeshura nga mbikëqyrësit;
- përgatitja e disa projektndryshimeve në rregulloren “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave”, që synojnë përafrimin me ndryshimet më të fundit të vitit 2019 në *Capital Requirements Regulation* (CRR)<sup>5</sup> dhe në dokumentet e Komitetit të Bazelit mbi regjimin e ekspozimeve të mëdha. Gjatë vitit 2019, u zhvillua me bankat një analizë ndikimi (*impact study*), me qëllim matjen paraprake të efektit të ndryshimeve të parashikuara në përmbushjen e detyrimeve rregullative nga ana e bankave. Si pjesë e ndryshimeve rregullative ishte edhe rishikimi i formularëve të raportimit të bankave, me qëllim lehtësimin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave të raportuara prej tyre, si dhe shtimin e disa zërave të rinj për raportim;

---

<sup>5</sup> Ndryshuar me rregulloren e BE-së 2019/876/EU, të quajtur CRR2.



- përgatitja e disa projektndryshimeve në rregulloren “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”, që synojnë përshtatjen me dinamikën e veprimtarisë dhe zhvillimit të tyre gjatë viteve të fundit;
- ka filluar puna për hartimin e projektregulloreve të reja “Për raportin e levës financiare të bankave”, për të cilin u ngrit grupi i punës përkatës. Hartimi i rregulloreve synon përafrimin me kërkesat e Bazel III, duke u bazuar në rregulloren e rishikuar evropiane (CRR2). Gjithashtu, në fund të vitit 2019, u kryen disa përllogaritje për vlerësimin paraprak të raportit të levës financiare, bazuar në të dhënat e raportuara nga bankat në formatin e raportimit *Corep*. Këto përllogaritje paraprake të treguesit u gjykuan të nevojshme, duke shërbyer njëkohësisht dhe si një bazë fillestare për të vijuar më tej me hartimin e rregulloreve të reja.


Në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve të Deloitte, me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor, rregullativ dhe mbikëqyrës të drejtimit të përgjegjshëm dhe efektiv të bankave, u punua për:

- hartimin e projektudhëzimit “Mbi drejtimin e brendshëm dhe efektiv të bankave”, objekti i të cilit është përcaktimi i kërkesave dhe rregullave bazë për përmirësimin e drejtimit të përgjegjshëm dhe efektiv në bankat dhe degët e bankave të huaja, nëpërmjet ngritjes së strukturave të duhura, përshtatshmërisë individuale dhe kolektive të anëtarëve të organeve drejtuese, hartimit të politikave, krijimit të komiteteve dhe përcaktimit të roleve dhe përgjegjësisë për secilin komitet, krijimin e kulturës së drejtimit dhe kulturës së rrezikut, si dhe krijimin e një kuadri të duhur të oreksit/tolerancës ndaj rrezikut;
- hartimin e propozimeve për ndryshime në rregulloren “Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre” dhe në rregulloren “Për sistemin e kontrollit të brendshëm”; dhe
- rishikimin e manualit të brendshëm për vlerësimin e rreziqeve;

Edhe gjatë vitit 2019, Departamenti i Mbikëqyrjes vazhdoi të kontribuojë si pjesë e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për shërbimet e pagesave”, në kuadër të angazhimit të Bankës së Shqipërisë për përafrimin e kuadrit ligjor me direktivën evropiane për shërbimet e pagesave (PSD2)<sup>6</sup>.

Gjithashtu, Departamenti i Mbikëqyrjes ka dhënë kontributin e tij në kuadër të anëtarësimit në Grupet Ndërinstitucionale të Punës (GNP) për Integrimin Evropian, për disa kapituj të rëndësishëm.


<sup>6</sup> *Payment Services Directive 2.*





## 4.2 LICENCIMI

Struktura e sistemit bankar dhe financiar, në fund të vitit 2019, përbëhet nga 12 banka, 32 subjekte financiare jobanka, 503 zyra të këmbimit valutor, 14 shoqëri të kursim-kreditit dhe 1 union i shoqërive të kursim-kreditit.




Banka e Shqipërisë, bazuar në ligjin “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, ka autoritetin të licencojë dhe mbikëqyrë bankat, subjektet financiare jobanka, shoqëritë e kursim-kreditit e unionet e tyre, zyrat e këmbimit valutor dhe zyrat e përfaqësimit të bankave të huaja.

### 4.2.1. BANKAT

Gjatë vitit 2019, në kuadër të përmbushjes së funksionit licencues, Banka e Shqipërisë ka marrë vendime që lidhen me:

- miratimin për transferimin 100% të pronësisë së aksioneve të Bankës Ndërkombëtare Tregtare sh.a. tek Banka Union sh.a. dhe riorganizimin juridik të Bankës Union sh.a. nëpërmjet bashkimit me përthithje me Bankën Ndërkombëtare Tregtare sh.a.;
- revokimin e licencave të dy bankave, përkatësisht të licencës së Bankës Ndërkombëtare Tregtare sh.a., pas përfundimit të procesit të bashkimit me përthithje me Bankën Union sh.a. dhe të licencës të Bankës së Kreditit të Shqipërisë sh.a. si rezultat i kalimit në procesin e likuidimit vullnetar;



- miratimin për transferimin e 88.89% të pronësisë së aksioneve të Bankës Societe Generale Albania sh.a. tek OTP Bank Nyrt, Hungari;
- miratimin për transferimin e 98.83% të pronësisë së aksioneve të Bankës Tirana sh.a. tek Balfin sh.p.k., Shqipëri;
- miratimin për zotërimin e pjesëmarrjes influencuese (të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë), duke tejkaluar 20% të kapitalit të Bankës Credins sh.a. nga shoqëria Amryta Capital LLP, Mbretëria e Bashkuar;
- miratimin për ndryshimin e emrit të Bankës Societe Generale Albania sh.a. në Banka OTP Albania sh.a.;
- miratimin për kryerjen e veprimtarisë së ndërmjetësimin në sigurime nga Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a.;
- miratime për 64 administratorë të bankave, të cilët sipas pozicioneve renditen respektivisht në: 31 anëtarë të këshillave drejtues, 13 anëtarë të komiteteve të kontrollit dhe 20 drejtues ekzekutivë dhe drejtues të kontrollit të brendshëm;
- miratime të zgjerimit të rrjetit të bankave me 5 degë të reja, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
- miratime të ndryshimeve në statutet e bankave, përkatësisht të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a., të Bankës Raiffeisen sh.a., të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a., të Bankës Credins sh.a., të Bankës Intesa Sanpaolo Albania sh.a., të Bankës OTP Albania sh.a. (ish-Banka Societe Generale Albania sh.a.);
- miratime/moskundërshtime për emërimet/riemërimet e ekspertëve kontabël të autorizuar për auditimin e pasqyrave financiare të fundvitit 2019 të të gjitha bankave;
- miratime për emetim të borxhit të varur nga Banka Credins sh.a., Banka e Parë e Investimeve Albania sh.a., Banka ProCredit sh.a.
- miratime për shlyerjen e borxhit të varur nga Banka Amerikane e Investimeve sh.a. dhe Banka ProCredit sh.a.;
- miratimin për nënshkrimin e marrëveshjes me të tretët (*outsourcing*) nga Banka Raiffeisen sh.a.;
- miratime për ofrimin e shërbimeve *e-banking* nga Banka ProCredit sh.a. dhe Banka Kombëtare Tregtare sh.a.

#### 4.2.2. SUBJEKTET FINANCIARE JOBANKA, INSTITUCIONET FINANCIARE TË MIKROKREDISË DHE INSTITUCIONET E PARASË ELEKTRONIKE

Vendimmarrja e Bankës së Shqipërisë, për subjektet financiare jobanka, institucionet financiare të mikrokredisë dhe institucionet e parasë elektronike, gjatë vitit 2019, konsiston në:

- a) licencimin e një subjekti financiar jobankë për ushtrimin e veprimtarisë financiare të faktoringut (Tirana Capital Trade sh.p.k.) dhe të një institucioni financiar të mikrokredisë (Micro Credit Risk sh.p.k.).
- b) miratime për transferimin e kuotave të kapitalit të subjekteve financiare jobanka "Kredo Finance" sh.p.k., "Tirana Factoring & Lease" sh.a.,



“Final” sh.a.;

- c) miratime të 9 administratorëve të subjekteve financiare jobanka;
- d) pezullimin e licencës së subjektit financiar jobankë “Platinum Investment” sh.p.k., me kërkesë të subjektit.

Gjatë vitit 2019, bankat dhe subjektet financiare jobanka njoftuan për ndryshime strukturore në pronësinë e kapitalit, të cilat konsistojnë kryesisht në ndryshime të pjesëmarrjeve joinfluencuese në zotërimin e aksioneve apo të kuotave. Ndërkohë, disa prej këtyre subjekteve kanë njoftuar edhe për rritje të kapitalit të tyre të paguar.

#### **4.2.3. SHOQËRITË E KURSIM-KREDITIT DHE UNIONET E SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT**

Vendimmarrja e Bankës së Shqipërisë, në kuadër të përbushjes së funksionit licencues, për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e shoqërive të kursim-kreditit, gjatë vitit 2019, konsiston në:

- a) licencimin e shoqërisë së kursim-kreditit “Tirana Invest Kredit 2000”;
- b) miratimin e drejtuesve të shoqërive të kursim-kreditit, si kërkesë e ligjit “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, dhe të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”. Miratimet u dhanë për 2 kryetarë të këshillave drejtues dhe 2 administratorë të një shoqërie kursim-krediti dhe të unionit të shoqërive të kursim-kreditit.

#### **4.2.4. ZYRAT E KËMBIMIT VALUTOR**

Vendimmarrja e Bankës së Shqipërisë, në kuadër të përbushjes së funksionit licencues, për zyrat e këmbimit valutor, konsiston në:

- a) licencimin e 51 zyrave të reja të këmbimit valutor;
- b) revokimin e licencës së 11 zyrave të këmbimit valutor, për shkak të ndërprerjes së veprimtarisë.


#### **4.2.5. TË TJERA**

Në fund të vitit 2019, bankat e ushtrojnë veprimtarinë nëpërmjet 429 degëve/agjencive, të shtrira brenda territorit të vendit. Zhvillimi i teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, si dhe ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut në përdorimin e aplikacioneve bankare dhe financiare nëpërmjet pajisjeve dhe kanaleve të komunikimit në distancë (*smart phone, mobile phone, website, personal computer, etj.*) janë faktorë që vijojnë të ndikojnë në zvogëlimin e numrit të degëve të bankave. Këto kanale të komunikimit në distancë mundësojnë dhe lehtësojnë përdorimin dhe kryerjen e transaksioneve bankare dhe financiare në kohë reale, në 24 orë gjatë 7 ditëve të javës, dhe optimizojnë shtrirjen e rrjetit




të bankave. Gjithashtu, në rënien e numrit të degëve fizike, kanë ndikuar edhe riorganizimet juridike të bankave, nëpërmjet bashkimit me përhithje gjatë dy viteve të fundit. Nga këto riorganizime, bankat përhithëse kanë mbyllur degët me prani të dubluar në të njëjtën zonë gjeografike.

Grafik 2. Ecuria e numrit të degëve/agjencive të bankave në vite



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 3. Shpërndarja gjeografike e popullsisë banuese dhe rrjetit të degëve/agjencive të bankave, sipas qarqeve, në vitin 2019 (në përqindje)




Burimi: Instat, Banka e Shqipërisë.

Shpërndarja gjeografike e degëve/agjencive bankare përfshin pothuajse të gjithë territorin e vendit. Përqendrimi më i madh i degëve dhe agjencive bankare është në Tiranë (42.66%), ku edhe përqendrimi i popullsisë është më i madh (31.84%). Po kështu, evidentohet që shpërndarja e degëve dhe agjencive bankare sipas rajoneve është në përpjesëtim me numrin e popullsisë.


Gjatë vitit 2019, vijoi ritmi i lartë i aplikimeve për ushtrimin e veprimtarisë financiare të këmbimit valutor. Në fund të këtij viti, kjo veprimtari ushtrohet nga 503 zyra këmbimi valutor. Gjatë vitit u dhanë 51 licenca të reja dhe u revokuan 11 licenca për zyra të këmbimit valutor.

Grafik 4. Ecuria e numrit të zyrave të këmbimit valutor të licencuara në vite



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në zbatim të kërkesave të kuadrit rregullativ në fuqi, subjektet financiare jobanka dhe institucionet e parasë elektronike mund të ushtrojnë veprimtarinë e shërbimeve të pagesave dhe të transferimit të parave dhe/ose të shpërndarjes dhe të ripagimit të fondeve, në rastin e institucioneve të parasë elektronike, edhe nëpërmjet agjentëve. Në fund të vitit 2019, numri i agjentëve të këtyre subjekteve është 1,176. Posta Shqiptare e ushtron veprimtarinë e shërbimeve të pagesave dhe transferimit të parave nëpërmjet zyrave postare të shpërndara në të gjithë territorin e Shqipërisë.



Tabelë 2. Numri i agjentëve të subjekteve financiare jobanka dhe të institucioneve të parasë elektronike, në fund të vitit 2019

	AK-INVEST	UNION FINANCIAR TIRANË	EASYPAY	PAY AND GO	RAEA FINANCIAL SERVICES	TOTALI
Agjentë që kryejnë veprimtarinë e transferimit të parave në emër të subjektit financiar jobankë	229			92	44	365
Agjentë të institucionit të parasë elektronike		369	442			811
TOTALI	229	369	442	92	44	1,176

Burimi: Banka e Shqipërisë.

